

Alkooli / duhani / droga

Kushdo që mbanë, konsumon apo shet drogë, bënë vepër penale. Për shitjen e alkoolit dhe duhanit ka kufinjë moshe.

Drogat

Mbajtja, shitja apo konsumimi i drogave ilegale është vepër penale. Kjo vlenë edhe për sasi të vogla. Cilat substanca janë ilegale, është e rregulluar me ligjin për substancat narkotike (Betäubungsmittelgesetz). Shitja e drogave në mënyrë biznesore ndëshkohet me gjoba të larta.

Alkooli dhe duhani

Për shitjen e alkoolit dhe duhanit ka kufizim të moshës. Kështu në kantonin Aargau duhani dhe pijet alkoolike nuk guxojnë tu shiten fëmijëve dhe të rinjëve nën moshën 16 vjeçare. Për pije alkoolike të veçanta si spirituozet, kufiri qëndron te mosha 18 vjeçare.

Ndalimi i pirjes të duhanit

Ndalimi i pirjes të duhanit në Zvicër dallon nga kantoni në kanton. Kantoni i Aargaut mbështetet në ligjin federal për mbrojtjen e duhanpirësve pasiv dhe nuk njih ligj tjetër të dhënë prej kantonit.

Ndalim i pirjes të duhanit vlen në:

- Hapësira të mbyllura, të çasshme për publikun (spitale, administrata, shkolla, muze, kino, teatër, trena, autobusë, shitore, dhe qendra tregtare).
- Hapësira, në të cilat shumë persona i kanë vendet e tyre të punës.

Se a është e lejuar pirja e duhanit në restorant, varet nga madhësia e restorantit. Në shumë restorane ka hapësira të veçanta për pirjen e duhanit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-aargau.ch/sq/mire-me-dit/alkooli--duhani--droga